



Përse duhet të testohem?

Duke bërë shumë testime, ju ndihmoni për të identifikuar shpejt dhe në një fazë të hershme infektimet që përndryshe do të kishin mbetur të pazbuluara. Si rrjedhojë, nëpërmjet karantinës shtëpiake mund të ndërpritet në fazë të hershme zinxhiri i infektimit. Kështu virusi mund të përhapet më pak. Ju mbroni veten dhe të tjerët!

Ku mund të testohem?

Qytetarët dhe qytetarët mund të përdorin të paktën njëherë në javë një test të shpejtë falas, të ashtuquajtur testi qytetar. Për këtë ata mund të përdorin qendrat dhe stacionet e autorizuara për testin të landeve dhe komunave. Në Nordrhein-Westfalen ka me mijëra vende testimi në mbarë landin. Një mundësi testimi pranë jush gjeni në www.testen.nrw.

Sa shpesh duhet të testohem?

Të paktën njëherë në javë. Në këtë mënyrë kryeni një kontribut të vlefshëm për të parandaluar koronavirusin.

Çfarë të bëj nëse rezultati i testit del pozitiv?

Një rezultat pozitiv i testit shkakton dyshimin për një infektim me SARS-CoV-2 dhe duhet të konfirmohet menjëherë nëpërmjet të ashtuquajturit testi PCR. Kontaktoni me anë të telefonit me një mjekë ose një mjek, me zyrën e shëndetësisë ose me një qendër testimi. Në rastin se rezultati i testit del pozitiv duhet të niseni nga ajo që ju jeni infektues për njerëzit e tjerë. Është urgjentisht e domosdoshme që të shkoni direkt në izolim shtëpiak dhe të shmangni kontaktet me njerëzit e tjerë. Vetëm nëse një test i mëvonshëm PCR nuk e konfirmon dyshimin, nuk ka më arsye për karantinën.

Çfarë procese të testit ka?

Aktualisht, procedurat e mëposhtme të testit përdoren kryesisht për të zbuluar SARS-CoV-2:

1. I ashtuquajturi **Testi PCR** merret nga personeli mjekësor dhe vlerësohet në një laborator mjekësor. Ai provon materialin gjenetik të patogjenit.
2. **Testi (i shpejtë) i antigjenit** reagon ndaj një fragmenti specifik proteinik të virusit. Ai kryhet nga personeli i trajnuar.
3. **Vetëtestimi**, i cili reagon si testi i shpejtë i antigjenit në një fragment specifik proteinik i virusit.

Testet PCR janë më të besueshmit ndër testet e koronës. P.sh. personeli mjekësor merr analizat nga hunda ose goja. Vlerësimi i testit PCR bëhet nëpërmjet një laboratorit. Rezultati i testit del më së shpejti katër deri në gjashtë orë. Koha ndërmjet marrjes së mostrave dhe raportimit të rezultatit mund të zgjasë për disa ditë në varësi të numrit të mostrave.

Testet e shpejta të antigjenit për SARS-CoV-2 kryhen vetëm **nëpërmjet personalitet të trajnuar**. Si tek testi PCR merren analizat e hundës dhe gojës. Ato japin shpejt në mënyrë të qartë, si rregull pas maks. 15 minutash, një rezultat të testit direkt në vend. Megjithatë, ato nuk janë aq të besueshme si një test PCR dhe paraqesin vetëm një

fotografi çasti. Në rastin e një rezultati pozitiv të testit të shpejtë duhet kryer menjëherë një test PCR për sqarim të mëtejshëm.

Që nga fillimi i marsit **vetëtestimet** janë të disponueshme në treg. Ato funksionojnë si testet e shpejta të antigjenit, por në parim mund të kryen nga çdo person. Marrja dhe vlerësimi i mostrave është përkatësisht i thjeshtë dhe i shpejtë. Sidoqoftë, besueshmëria e tyre varet nga marrja e mostrave dhe kryerja e saktë dhe në kohë e testit dhe është përgjithësisht më e ulët se ajo e testeve PCR. Nëse një vetëtestim shfaq dyshimin për një infektim, atëherë është menjëherë i nevojshëm një konfirmim nëpërmjet një testi PCR.

Qëndroni të shëndetshëm – qëndroni të informuar: www.land.nrw/corona